



**Për:** Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Rr. "Migjeni", ndërtesa e ish-Bankes së Lubljanës, kati i parë  
10000 Prishtinë, KOSOVË

**Nga:** Organizata GERMIN

Rr. "Tringë Smajli", nr. 48  
10000 Prishtinë, KOSOVË

**2 nëntor 2019**

## **ANKESË**

**RE:** Për moszbatimin e plotë të Aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme

**Pala përgjegjëse:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

### **Përshkrimi i rastit:**

Gjatë vëzhgimit të verifikimit dhe numërimit të pakove me fletëvotime të cilat kanë ardhur përmes postës pas datës 5 tetor, vëzhguesit e Organizatës GERMIN kanë vërejtur se KQZ nuk po e zbaton plotësisht vendimin A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme, lidhur me pranueshmërinë e votave në fjalë. KQZ nuk i ka procesuar fare 1806 pako me fletëvotime nga diaspora të cilat kanë arritur mes datës 11 tetor 2019, ditën kur është ushtruar ankesa ndaj Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka sjellë deri tek vendimi i Gjykatës Supreme për pranueshmërinë e fletëvotime të ardhura me postë pas datës së zgjedhjeve, dhe deri më datën 17 tetor 2019. Konsiderojmë që ky veprim i KQZ-së nuk është në përputhje me aktgjykimin A.A.UZH.nr. 20/2019 të datës 30.10.2019 të Gjykatës Supreme. 1806 pakot e patrajtuara të fletëvotimeve nga bashkëqytetarët tanë që jetojnë jashtë vendit janë refuzuar pa kaluar asnjë procedurë verifikimi. Të gjitha këto pako janë nisur si dërgesa postare para afatit përfundimtar për dërgimin e pakove postare të vendosur nga KQZ-ja, përkatësisht nga data 19 shtator deri më datën 5 tetor 2019, gjë që mund të vërtëtohet në bazë të vulës postare në datën e nisjes. Gjithashtu, 1806 pakot në fjalë kanë ardhur në KQZ përpara se të nisej verifikimi dhe numërimi i 4639 të tjerave që ishin objekt i ankesës së parë të LVV-së, e cila do të thotë se përfshirja në numërim e 1806 pakove të reja nuk do të kishte vonuar procedimi i pakove të tjera. Mostrajtimi i këtyre pakove të fundit bie në kundërshtim me aktgjyimin e Gjykatës Supreme A.A.UZH.nr. 20/2019 të datës 30.10.2019, si dhe me aktgjykimin më të hershëm të kësaj Gjykate, A.A.-U.ZH.nr. 19/2019 të datës 25.10.2019.

### **Baza Ligjore:**

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (tutje “Kushtetuta”), në nenin 45, i përkufizon të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes si vijon: *1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.*
2. Sipas nenit 22 të Kushtetutës: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj”.*
3. Në lidhshmëri me nenin 53 të Kushtetutës: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
4. Ligji Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (tutje si: “Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme”) përcakton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organ i pavarur përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve.
5. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 1.c, rregullon njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret e pranueshmërisë së votës. Ndërsa neni 2 i këtij ligji, në parim e përfshin edhe të drejtën që: *“Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtën për të votuar dhe për t’u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji”,* dhe që: *“Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar . . .”*
6. Të drejtën për të votuar, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e definojnë me nenin 5, si vijon: *“Çdo person ka të drejtë për të votuar në zgjedhje në përputhje me këtë ligj nëse i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese: a) është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil; b) banon jashtë Kosovës ose ka lëshuar Kosovën në apo pas 1 janarit 1998, me kusht që t’i plotësojë kriteret e parapara sipas ligjit në fuqi për të qenë qytetar i Kosovës”.*
7. Lidhur me pranueshmërinë e votave me postë të ardhura pas afatit ligjor, pas refuzimit të ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme A.A.UZH.nr. 20/2019 cilëson vendimin A nr. 375-2/2019, të datës 28.10.2019 të

PZAP-së si të pabazuer dhe “[...]Jurdhërohet KQZ për numërimin e të gjitha pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës”

8. Dispozitat që e rregullojnë procesin e ankesave dhe apelimit pranë PZAP, përcaktohen me nenin 119 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme: “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të KZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë një ankesë pranë KZAP-it”; nenin 122.2: “KZAP-i do të mbështesë apelin ndaj vendimit të KQZ-së nëse vlerëson se KQZ-ja nuk ishte e arsyeshme në marrjen parasysh të të gjitha rrethanave”; nenin 122.3: “Nëse KZAP-i mbështet apelin ndaj vendimit të KQZ-së, mundet të: a) udhëzojë KQZ-n ta rishqyrtojë vendimin e vet; dhe b) udhëzojë KQZ-në të marrë masa kompensimi”; dhe Rregullën NR.2/2015, neni 5.
9. Mënyra e votimit jashtë vendit përcaktohet përmes Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr. 03/2013 mbi Votimin jashtë Kosovës, sipas neni 4.1: “Votuesi me zotësi juridike i cili është regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës mund ta marrë fletëvotimin: a) duke pranuar fletëvotimin(et) në adresë ekzistuese jashtë Kosovës të cilën ai/ajo e jep për këtë qëllim; b) duke marrë personalisht fletëvotimin(et) nga njëra nga pikat e shpërndarjes jashtë Kosovës, të përcaktuara dhe të publikuara nga KQZ-ja; c) duke bërë fotokopje fletëvotimin(et) që ekzistojnë në pikat e shpërndarjes të përcaktuara në pikën 4.1 të kësaj rregulle, ose d) të shkarkojë fletëvotimin nga web faqja e KQZ-së në internet”; Pika 2 vazhdon si vijon: “Pas plotësimit të fletëvotimit(eve) votuesi duhet të vendosë fletëvotimin(et) në një zarf të pashënuar e të mbyllur të vendosur brenda zarfit të jashtëm/për dërgim. Në zarfin e dërgimit votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij ose saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij ose saj dhe që përmban se paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij ose saj”; Pika 3 thotë: “Pas plotësimit të fletëvotimit për votim jashtë Kosovës, votuesi duhet ta dërgojë atë në postë në njërën nga kutitë postare që ngrihen dhe shpallen publikisht nga KQZ-ja, deri në datën që përcaktohet nga KQZ-ja”; Ndërsa Pika 4 përcakton afatin e pranimit të votave jashtë Kosovës: “Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ-ja 24 orë para ditës së zgjedhjeve”.
10. Neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 përcakton dorëzimin e zarfeve të konfirmuara më shënimet për identifikim të bashkangjitura dhe të klasifikuara në baze të komunave në QNR, nga njësitë e votimit jashtë Kosovës, ndërsa QNR [...] “do t’i procedojë zarfet dhe fletëvotimet e votuesve jashtë Kosovës, në bazë të diaspozitave të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së Nr. 06/2013 mbi Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve”.

### **Arsyetim:**

Për sa i përket vlefshmërisë së votave me postë të ardhura pas afatit ligjor dhe Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr. 03/2013, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 ka vendosur qartë se mospranimi i votave të ardhura me postë pas datës 5 tetor përbën shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatueshmëria e së cilës garantohet nga neni 22 i Kushtetutës së Kosovës. Aktgjykimi në fjalë i Gjykatës Supreme konstaton se *“neni 96 par. 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe neni 4 par. 4 i Rregullës Zgjedhore nr. 03/2013 janë në kolizion me nenin 3 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili përfshin të drejtën për zgjedhjet e lira, dhe në rastin konkret votuesit pa fajin e tyre ishin privuar nga mundësia për të shprehur mendimin e tyre në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës, votuesve u është mohuar veti thelbi i së drejtës për të votuar, siç garantohet nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Po ashtu, refuzimi për të proceduar 1806 pakot në diskutim bie ndesh gjithashtu me aktgjykimin e parë të Gjykatës Supreme lidhur me këtë rast, A.A.UZH.nr. 20/2019, i cili, duke u mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 127, par. 2, konstaton se votat e nisura me postë përpara datës së zgjedhjeve *“duhet të trajtohen sikur kanë arritur në KQZ brenda afatit të pranueshëm”*. Të gjitha 1806 pakot e panumëruara janë nisur përpara datës së zgjedhjeve. Përkatësisht, janë dorëzuar me postë nga data 19 shtator deri më 5 tetor 2019. Rrjedhimisht, sipas arsytimit të kësaj Gjykate, edhe ato *“duhet të trajtohen sikur kanë arritur në KQZ brenda afatit të pranueshëm”* dhe duhet t’i nënshtrohen të njëjtit proces të verifikimit dhe numërimit, në mënyrë të barabartë me të tjerat.

Gjithashtu, në aktgjykimin e saj më të fundit (A.A.UZH.nr. 20/2019), kjo Gjykatë ka arsyetuar se numërimi i 4639 pakove që ishin objekt i atij rasti, duhej të kryhej, për shkak se *“procesi i numërimit të fletëvotimeve ka qenë në vazhdim e sipër dhe kjo [arritje me vonesë e pakove] nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit të fletëvotimeve”*. Në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtën arsye, përfshirja e 1806 pakove të fundit *“nuk kishte për të ndikuar në rregullsinë e procesit të numërimit të fletëvotimeve”*, përderisa ato pako kishin ardhur të gjitha përpara se të fillonte verifikimi dhe numërimi i 4639 pakove të tjera, më 31 tetor 2019. Rrjedhimisht, në bazë të arsytimit të kësaj Gjykate, edhe 1806 pakot në diskutim duhet të verifikohen dhe të numërohen, sidomos duke marrë parasysh se numërimi i tyre nuk do të kërkonte as një ditë të plotë, në qoftë se KQZ i procedon me të njëjtën shpejtësi me të cilën i ka proceduar 4639 pakove më të fundit, të cilat janë verifikuar dhe numëruar brenda dy ditëve.

Mospranimi i 1806 pakove të fletëvotimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit, por të cilat kanë arritur pas afatit të vendosur nga KQZ, cenon sërish të drejtat zgjedhore të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës dhe parimin e votimit universal. Ky veprim shkel po ashtu edhe parimin e barazisë së votës sipas të cilit, e drejta e votës nuk nënkupton vetëm të drejtën për të votuar por edhe të drejtën e efektit të barabartë të votës me votat e qytetarëve të tjerë të Republikës. Duke pasur parasysh që në këtë rast KQZ nuk e ka vlerësuar fare vlefshmërinë e votave në këto 1.806 pako, sepse nuk ka pranuar t’i trajtojë ato, dhe se ligjshmëria e tyre duhet të pranohet në bazë të dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, humbja e votës nuk është aspak e justifikueshme. Rrjedhimisht, mosnumërimi i fletëvotimeve nga këto pako, edhe pas aktgjykimit A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme, e bën të kontestueshëm gjithë procesin e numërimit të votave dhe cenon integritetin e këtyre zgjedhjeve.

Fakti që në aktgjykimin A.A.UZH.nr. 20/2019 të Gjykatës Supreme pranohet rregullësia dhe vlefshmëria e 4.639 pakove me fletëvotime nuk do të thotë që votat e tjera të ardhura prej momentit kur është bërë ankesa (11.10.2019) dhe deri në fillimin e verifikimit të tyre (31.10.2019), janë të papranueshme. Vlefshmëria e votave të ardhura përmes postës, e përcaktuar me dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme, nuk mund të reduktohet në numra, por në parimet mbi të cilat janë vendosur këto aktgjykime.

Kjo është pranuar edhe më herët nga KQZ kur aktgjykimi AA.-Uzh.nr.16/2017 i Gjykatës Supreme për certifikimin e një kandidati në listën zgjedhore, është zbatuar për të gjithë kandidatët tjerë në kategorinë e njejtë, sepse aktgjykimi edhe pse kishte për objekt një kandidat, kishte vendosur një parim që vlen edhe për rastet e tjera të të njejtës natyrë.

Sipas logjikës së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme për votat me postë, të gjitha pakot me fletëvotime të nisura para ditës së zgjedhjeve, të cilat kanë arritur në KQZ deri në ditën përpara procesimit të 4639 pakove për të cilat është ushtruar ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, duhej të procesoheshin së bashku me to. Përkitazi me këtë, 1806 pakot me fletëvotime janë po aq të vlefshme sa 4.639 pakot e tjera të numëruara tashmë nga KQZ dhe duhet të procesohen, pa vonesë.

**Prandaj, kërkohet nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, që sipas mandatit që ia jep Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 115.1, dhe në bazë të aktgjykimeve A.A.UZH. nr. 20/2019 dhe A.A.UZH. nr. 19/2019 të Gjykatës Supreme, të ndërmarrë veprime konkrete dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të numëruar 1.806 pakot e mbetura me fletëvotime të ardhura përmes postës.**

Sinqerisht,

Liza Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive



---

OJQ GERMIN